

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“Zdravo Energy” sh.p.k

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 05/12/2022, Themeluesi:

1. **"Bashkimi/L" sh.p.k**, me Nuis **J64103475Q**, dhe adrese Autostrada Lushnje-Fier km 4, Pasuria me nr 104/18 ne zonen kadastrale 3268
Me perfaqesues:

Dashnor Sinanaj lindur në Berat më 14/04/1979, banues në Lushnje, me leternjoftim nr personal **H90414115N**.


Ylli Zdrava lindur ne Kucove me 08/02/1975, banues ne Lushnje, me leternjoftim nr personal **H50208021L**.

Kastriot Sinanaj lindur ne Berat me 21/03/1977, banues ne Lushnje, me leternjoftim nr personal **H70321109W**.

2. **"Zdrava 07" sh.p.k**, me Nuis L34131401F, dhe adrese Lushnje SAVER Lagjja Saver, Autostrada Lushnje - Fier km 4, nr pasurie 104/42, zona kadastrale 3268.
Me perfaqesues:

Ferdinant Sinanaj lindur ne Kucove me 28/01/1968, banues ne Lushnje, me leternjoftim nr personal **G80128091V**.

Deklaron se ka vendosor të nënshkruaj këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë referuar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.



Neni 1-Emërtimi
Emërtimi i shoqërisë është

“Zdravo Energy” sh.p.k

Emri tregtar i shoqërisë : “Zdravo Energy” sh.p.k

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

Neni 2-Vëndndodhja e selisë

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet: Lushnje, Lagjja Xhevdet Nepravishta, Ish godina e plastmasit.

Neni 3- Kohëzgjatja


Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare të Regjistrimit.

Neni 4- Objekti i veprimtarisë

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

1. Në fushën e tregtisë shoqëria do të kryejë: Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e erez, termocentralet, biomasa etj.
- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmese. Përfshirë dhe pa u kushtezuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energji elektrike (vendas apo të huaj), si dhe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit.
- Përveç sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektin e mesiperm. Për arritjen e qëllimit të mesiperm, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë.



• Duke përfshirë por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstacione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit etj., si dhe cdo aktivitet aksesor i lidhur me sa më sipër, si punime gërmimi, punime për prishjen dhe punime të tjera të tokës, punime civile, elektrike dhe mekanike të cdo lloji si dhe blerje, shitje, shkëmbim, import-eksport të pajisjeve, riparim dhe mirëmbajtje të materialeve dhe pajisjeve dhe të gjithë aktivitetet e lidhura me këto çështje, gjithashtu dhe në fushën e aktivitetëve të tregtimit.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

Neni 5- Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) leke.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 2 (dy) pjesë kapitali me vlerë nominale 80.000 (Tetëdhjetë mijë) leke, dhe 20.000 (Njëzetë mijë) leke.

Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar

1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë) leke.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 2 (dy) pjesë kapitali me vlerë nominale 80.000 (Tetëdhjetë mijë) leke dhe 20.000 (Njëzetë mijë) leke.

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

Kapitali i mesipër është nënshkruar dhe shlyer teresisht në të holla nga ortakët e shoqërisë përkatësisht:


1. **"Bashkimi/L" sh.p.k**, me NUIS **J64103475Q**, dhe adresë Autostrada Lushnje-Fier km 4, Pasuria me nr 104/18 në zonën kadastrale 3268. Me kuotë me vlerë 80.000 (Tetëdhjetë mijë) lekë, që cili përbën 80% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Me përfaqësues:

Dashnor Sinanaj lindur në Berat më 14/04/1979, banues në Lushnje, me letërnjoftim nr personal **H90414115N**. Vlera e kapitalit të përgjithshëm **30.000** Leke, numri i pjesëve 1, që përben 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ylli Zdrava lindur në Kucovë më 08/02/1975, banues në Lushnje, me letërnjoftim nr personal **H50208021L**. Vlera e kapitalit të përgjithshëm **30.000** Leke, numri i pjesëve 1, që përben 30% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kastriot Sinanaj lindur në Berat më 21/03/1977, banues në Lushnje, me letërnjoftim nr personal **H70321109W**. Vlera e kapitalit të përgjithshëm **20.000** Leke, numri i pjesëve 1, që përben 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



2. **"Zdrava 07" sh.p.k**, me Nuis **L34131401F**, dhe adrese Lushnje SAVER Lagjja Saver, Autostrada Lushnje - Fier km 4, nr pasurie 104/42, zona kadastrale 3268. Me kuotë me vlerë 20.000 (Njëzetë mijë), lekë, që cili përbën 20% te kapitalit themeltar te shoqërise.

Me perfaqesues:

Ferdinant Sinanaj lindur ne Kucove me 28/01/1968, banues ne Lushnje, me leternjoftim nr personal **G80128091V**. Vlera e kapitalit te pergjithshem 20.000 Leke, numri i pjeseve 1, qe perben 20% te kapitalit themeltar te shoqërise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqërise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqërise

Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8- Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
1. **Administratori i vetem i shoqërisë është Z Ylli Zdrava** lindur në Berat më 08/02/1975, banues në Lushnje, me leternjoftim nr personal **H50208021L**.
3. Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në regjistrin tregtar.

Neni 9- Të tjera

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni - 10

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpëdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.


Neni - 11

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.


Parë dhe miratuar në Tiranë , më 05/12/2022.

ORTAKET E SHOQERISE


Dashnor Sinanaj



Ylli Zdrava



Kastriot Sinanaj



Ferdinant Sinanaj

